


Përgjigju duke e rrethuar shkronjën para njëres nga përgjigjet e dhëna. Çdo përgjigje e saktë sjell 2 pikë.
Të shkruarit me laps, rrethimi i dy ose më tepër përgjigjeve ose shlyerja e përgjigjes nuk vlerësohet.

TEST ME MË SHUMË PËRGJIGJE TË DHËNA PREJ TË CILAVE VETËM NJË ËSHTË E SAKTË
(Përgjigju me rrethim të **vetëm një** përgjigje të dhënë nën A, B, C dhe D)

1. Simbolet kimike duhet të kenë më së paku:

- A. Një shkronjë të madhe
- B. Një shkronjë të vogël
- C. Dy shkronja të vogla
- D. Një shkronjë të madhe dhe një të vogël

2. Numri atomik i atomit të skicuar më poshtë është:



- A. 17
- B. 18
- C. 35
- D. 35,45

3. Sa elektrone valente ka atomi i klorit,



- A. 1
- B. 6
- C. 7
- D. 17

4. Në cilën shtresë elektronike të radhës gjendet elektroni valent i atomit të elementit me numër rendor 11?

- A. 1
- B. 3
- C. 11
- D. 12

5. Mendeleevi i ka radhitur elementet sipas rritjes së:

- A. Numrit atomik
- B. Numrit të masës
- C. Masës atomike
- D. Elektroneve valente

6. Në cilin grup ka jometale më reaktive?

- A. 1
- B. 2
- C. 17
- D. 18

7. Çka paraqet numri atomik?

- A. Vetëm numrin e elektroneve
- B. Vetëm numrin e protoneve
- C. Vetëm numrin e neutroneve
- D. Vetëm numrin e elektroneve valente

8. Sa elektrone prej atomit të fosforit (numri atomik 15) marrin pjesë në formimin e lidhjeve kovalente me atomin e hidrogjenit?

- A. 2
- B. 3
- C. 5
- D. 7

9. Formula kimike e metanit është CH_4 . Prej sa elementeve është i ndërtuar ky komponim?

- A. 1
- B. 2
- C. 4
- D. 5

10. Numër më të madh të atomeve ka në një njësi të:

- A. Nitratis të natriumit
- B. Karbonatis të litiumit
- C. Hidroksidit të aluminit
- D. Acidit sulfhidrik

11. Në cilin varg të gjithë metalet kanë valencë të njëjtë?

- A. CrO , Cr_2O_3 , CrO_3
- B. BeCl_2 , CuBr , MnO_2
- C. K_2S , Na_2SO_4 , CuCl_2
- D. SnCl_4 , PbS_2 , MnO_2

Përgjigju duke e rrethuar shkronjën para njëres nga përgjigjet e dhëna. Çdo përgjigje e saktë sjell 2 pikë.
Të shkruarit me laps, rrethimi i dy ose më tepër përgjigjeve ose shlyerja e përgjigjes nuk vlerësohet.

12. Formula empirike e dekaoksid tetrafosforit është:

- A. PO
- B. PO₂
- C. P₂O₅
- D. P₄O₁₀

13. Një atom i elementit X mund të lidhet me dy atome të oksigjenit. Formula kimike e klorurit të elementit X është:

- A. XCl
- B. XCl₂
- C. X₂Cl
- D. XCl₄


14. Pse ngritja e temperaturës shkakton zmadhim të shpejtësisë së reaksionit?

- A. Ngritja e temperaturës e zmadhon energjinë të cilën e posedojnë reaktantët, ndërsa me atë edhe shpejtësinë e reaksionit.
- B. Ngritja e temperaturës e zmadhon përqëndrimin e reaktantëve, ndërsa me atë edhe shpejtësinë e reaksionit.
- C. Ngritja e temperaturës e zmadhon madhësinë e molekulave, ndërsa me atë edhe shpejtësinë e reaksionit.
- D. Ngritja e temperaturës e zmadhon sipërfaqen prekëse, ndërsa me atë edhe shpejtësinë e reaksionit.

15. Enzimet mundësojnë që reaksioni të zhvillohet _____ dhe e _____ energjinë e aktivizimit.

- A. Më shpejtë, zmadhojnë
- B. Më shpejtë, zvogëlojnë
- C. Më ngadalë, zmadhojnë
- D. Më ngadalë, zvogëlojnë

16. Në bazë të diagramit, përcakto cila fjali saktë e paraqet pikën A të grafikut.



- A. Reaksioni ka përfunduar.
- B. Reaksioni ngadalësohet.
- C. Reaksioni është më i ngadalshëm.
- D. Reaksioni është më i shpejtë.

17. Në jonin e formuar prej atomit me 9 protone dhe 10 neutrone, numri i përgjithshëm i elektroneve është:

- A. 1
- B. 8
- C. 9
- D. 10

18. Sa elektrone ka në shtresën e fundit të jonit sulfur (numri atomik i sulfurit është 16)?

- A. 2
- B. 6
- C. 8
- D. 16

19. Tek cila prej dysheve të elementeve të mëposhtme mund të formohet lidhje jonike?

- A. H dhe C
- B. Mg dhe F
- C. K dhe Na
- D. H dhe O

Përgjigju duke e rrethuar shkronjën para njëres nga përgjigjet e dhëna. Çdo përgjigje e saktë sjell 2 pikë.
Të shkruarit me laps, rrethimi i dy ose më tepër përgjigjeve ose shlyerja e përgjigjes nuk vlerësohet.

20. Çka nga e/të paraqitura/t është e saktë?

Elektricitet përçon:

- I. Klorur natriumi i ngurtë
 - II. Klorur natriumi i shkrirë
 - III. Tretësirë e klorur natriumit
- A. Vetëm I
 - B. Vetëm III
 - C. I dhe III
 - D. II dhe III

21. Cili është barazimi kimik i saktë dhe i barazuar i reaksionit të zbërthimit të peroksid hidrogjenit?

- A. $\text{H}_2\text{O}_2 = 2\text{H} + 2\text{O}$
- B. $\text{H}_2\text{O}_2 = \text{H}_2\text{O} + \text{O}_2$
- C. $2\text{H}_2\text{O}_2 = \text{H}_2\text{O} + 2\text{O}_2$
- D. $2\text{H}_2\text{O}_2 = 2\text{H}_2\text{O} + \text{O}_2$

22. Magnezi metalik mund të reagojë me sulfat hekurin(III), nga çka fitohet hekur elementar dhe sulfat magnezi. Koeficientët para simboleve kimike dhe formulave në barazimin e barazuar (sipas renditjes së përmendjes) janë:

- A. 3, 1, 2, 3
- B. 1, 1, 1, 1
- C. 3, 1, 1, 3
- D. 1, 1, 3, 1

23. Cila është formula kimike e sulfatit të amonit?

- A. NH_4SO_4
- B. $\text{NH}_4(\text{SO}_4)_2$
- C. $(\text{NH}_4)_2\text{SO}_4$
- D. $(\text{NH}_4)_4\text{SO}_4$

24. Ari mund të qëndroj i pastër sepse:

- A. Është metal i rrallë
- B. Është metal joreaktiv
- C. Është metal i shtrenjtë
- D. Është bërë prej meteorëve

25. Çka mund të përfundosh për titaniumin dhe magnezin nëse e din se është i mundur reaksioni në mes magnezit dhe klorur titanit(IV)?

- A. Titaniumi është jometal.
- B. Titaniumi është më i butë se magnezi.
- C. Titaniumi është më reaktiv se magnezi.
- D. Titaniumi është pas magnezit në vargun e reaktivitetit.